



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI

Nr. 462 prot.

Elbasan, më 24.02. 2026

UDHËZIM

Nr. 2 datë 24.02. 2026

**"PËR PROJEKT-PROPOZIMET E KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT SHKENCOR
ME MBËSHTETJE FINANCIARE NGA TË ARDHURAT E UNIVERSITETIT TË
ELBASANIT 'ALEKSANDËR XHUVANI'"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" neni 10 dhe 11, Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", e ndryshuar, me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e realizimit të aktiviteteve të kërkimit dhe zhvillimit shkencor në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani",

UDHËZOJ:

1. Për çdo vit akademik, personeli akademik me kohë të plotë dhe studentët e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" mund të aplikojnë për projekt-propozime të kërkimit dhe zhvillimit shkencor, për të cilat do të ofrohet mbështetje financiare nga të ardhurat e UE-së.
2. Rezultati kryesor i projektit duhet të jetë:
 - a) artikull shkencor, i cili do të publikohet në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga Journal Citation Reports dhe/ose Scopus.
 - b) Libër i abstrakteve, proceedings, monografi etj. të digjitalizuara (në kuadër të konferencave shkencore, simpoziumeve, forumeve etj.), të cilat do të publikohen online në faqen zyrtare të UE-së, mbas marrjes së numrit ISBN apo ISSN.
3. Të drejtën për të aplikuar si drejtues projekti e ka personeli akademik me kohë të plotë i UE-së. Si anëtarë të grupit kërkimor, mund të përfshihen edhe studentët.
4. Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë mund të aplikojë disa herë si anëtar grupi në të njëjtën thirrje, por vetëm një herë në cilësinë e drejtuesit të projektit.
5. Secili drejtues i projektit duhet të paraqesë Formularin e aplikimit të plotësuar sipas modelit bashkëngjitur këtij Udhëzimi.
6. Aplikimet duhet të dorëzohen pranë Zyrës së Protokollit në Rektoratin e UE-së, në formatin dhe afatin e përcaktuar në thirrjen për aplikime, e cila do të publikohet në faqen zyrtare të UE-së.

7. Projekt-propozimet do të vlerësohen mbi bazën e kritereve të mëposhtme:
 - Cilësia shkencore dhe origjinaliteti i projektit;
 - Realizueshmëria brenda afatit dhe buxhetit të parashikuar;
 - Përvoja dhe kapaciteti kërkimor i ekipit;
 - Përfshirja e studentëve në projekt;
 - Ndikimi i projektit, i vlerësuar mbi bazën e treguesve të qartë dhe të matshëm.
8. Çdo situatë apo çështje e paparashikuar në këtë udhëzim, do të shqyrtohet dhe vendoset nga Rektori, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.
9. Dokumentacioni fizik i aplikimeve do të administrohet nga Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, e cila është përgjegjëse për regjistrimin, ruajtjen dërgimin për vlerësim nga komisioni përkatës, dhe monitorimin e zbatimit të projektit.
10. Ngarkohet Drejtoria e e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë me ndjekjen e zbatimit të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë

REKTORI
Prof. Dr. Elvira Fetahu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI _____

FORMA E APLIKIMIT
PËR
PROJEKT PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM SHKENCOR

Modeli i Dokumentit të Projektit për Kërkim e Zhvillim Shkencor



1. Të dhënat e aplikantit për projektin për kërkim dhe zhvillim shkencor

Agjencia Ekzekutuese	IAL
Fakulteti	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
Titulli i Projektit	
Fusha shkencore ku aplikohet	
Kohëzgjatja e projektit (në muaj)	

2. Të dhënat e Drejtuesit të Projektit

Emër, mbiemër	
Fakulteti	
Departamenti	
Posti që mban	
Grada shkencore	
Adresa e e-mail	
Numri i celularit	
Punimet shkencore të kryera në pesë vitet e fundit	(Listo të gjitha projektet e kryera në pesë vitet e fundit)



2.1 Bashkëpunëtorë Shkencorë

Emër, mbiemër	
Fakulteti	
Departamenti	
Posti që mban	
Grada shkencore	
Numri i celularit	
Adresa e e-mail	
Detyrat në projekt	
Punimet shkencore të kryera në pesë vitet e fundit	(Listo të gjitha projektet e kryera në pesë vitet e fundit)

2.2 Personeli tjetër

Nr.	Emri	Profesioni dhe titulli/ grada
1.		
2.		
3.		
4.		

3. Argumentimi shkencor i Projektit. (max 1 faqe)

- 3.1 Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:
- 3.2 Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucionin tuaj ose në institucione të tjera.
- 3.3 Kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fundamentale dhe/ose të aplikuara

4. Qëllimi dhe objektivat e projektit (max 1 faqe)

- 4.1 Qëllimi
- 4.2 Objektivat e projektit

5. Aktivitetet e projektit (të lidhura me objektivat) (max 2 faqe)

- Aktivitet 1.
- Aktivitet 2.
- Aktivitet n.

6. Metodologjia e realizimit të projektit

- 6.1 Përshkrimi i detajuar i metodologjisë së kërkimit shkencor dhe i instrumentave shkencore që do të përdoren



7. Rezultatet e projektit (të lidhura me objektivat dhe aktivitetet) (max 2 faqe)

7.1 Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?

8 Përfituesit e projektit (Përshkruaj në mënyrë specifike cilët janë përfituesit direkt dhe indirekt të produktit të kërkimit shkencor e lidhur me fushën shkencore ku aplikohet)

8.1 Përfituesit direkt

8.2 Përfituesit indirekt

9 Plani i punës

Kalendari i aktiviteteve

Tabela përmbledhëse

Objektivi	Aktiviteti ¹	Rezultati	Periudha kohore (Muaji x-Muaji y)	Personi përgjegjës



10 Buxheti. Vlerësimi i projektit (në Mijë Lekë).

10.1 Shërbime nga të tretët (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.	Artikuj Kancelerie me logo UE (bloqe, stilolapsa, dosje etje)	
2.	Të tjera shpenzime operative (ftesa, postera, dekore etje.)	
3.	Botim artikulli shkencor në revista shkencore (Journal Citation Reports dhe/ose Scopus.)	
4		
Totali		

10.2. Shpenzime udhëtim e dieta (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.	Biletë udhëtimi të ftuar	
2.	Fjetje të ftuar	
Totali		

¹ Aktivitetet dhe periudha kohore e tabelave sipas viteve duhet të jenë të njëjta dhe të përkojnë me aktivitetet dhe periudhën kohore në tabelën përmbledhëse.



10.3 Shpenzime të tjera operative (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.	Shpenzime pritje - Katering/ koktej	
2.		
	Totali	

I. Burimet e Financimit të Projektit të shprehura në %.		
Burimet e Financimit	%	në Mijë Lekë
Shuma që do të financohet nga UE		
Shuma që do të financohet nga burime të tjera		
Gjithsej		

10.4 Nëse Projekti zgjat më shumë se një vit, jepet vlerësimi për fondet që kërkohen për çdo vit në Mijë Lekë :

Viti i financ	Shërb. të tretët	Shpenz. Udhëtime dieta	Shpenz. Të tjera operat.	Gjithsej	Nga burime tjera
Gjithsej					

Deklarim

Drejtuesi i Projektit deklaron se informacioni i paraqitur është i saktë dhe projekti do të zbatohet në përputhje me standardet etike dhe shkencore.



Drejtuesi i Grupit Kërkimor

Firma

Data :

Rrektori

Prof. Dr. Elvira Fetahu

Firma

Data :